

AKT- THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PROSA” sh.p.k

Në Durrës, sot më datë 04 Shkurt 2023.

Ortaku i vetëm themelues:

Z. Dann Vinther, i datëlindjes 23/10/1975, lindur në Faroe Islands, dhe banues në Torshavn Faroe Islands, shtetas Danez, madhor, me zotësi juridike për të vepruar identifikuar me Pasaport me Nr.210665662, me cilësinë e “Ortakut të vetëm themelues” kërkoi redaktimin e këtij akti themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroi se me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqërите tregëtare”, ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”, në atë Doganor,Fiskal Tatimor, krijon shoqerinë tregëtare, me përgjegjësi të kufizuar, “PROSA” Sh.p.k

KREU I
Neni 1

Krijimi

“PROSA” sh.p.k

Është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2


Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj Shoqëria “PROSA” sh.p.k, është një shoqëri tregëtare, e themeluar nga shtetas Danez **Z. Dann Vinther**, i cili pergjigjet për detyrimet e shoqërisë tregëtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributive të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në: Lagjia Nr.3, Rruga E.Zazani, Njesi ndertimi me siperfaqe 77 m², Nr.5, Shk.1, ZK 8512, Durrës. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , te hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendimin e Ortakut themelues .



Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Agjenci Komunikimi.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë, i nënshkruar plotësisht nga ortaku i vetëm themelues në masën 100%. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë ne para ose në natyrë (pasuri të luajtshme të paluajtshme apo të drejta). Ortaku i vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri ne çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE



Neni 8

Organ i Vendimmarrës

Ortaku i vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë. Ortaku i vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku vendos për çështje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet përiorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i drejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni përi pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni përi të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë SunnySide , caktohet **Z.Dann Vinther**, i cili emërohet përi një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtitje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të vetëm themelues të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregëtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

- b) Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Përgatisë dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpëndarjen e fitimeve i paraqësin këto dokumenta përpara asamblesë së përgjithshme për miratim
- e) Krijoi një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) Kryej regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në ligjin për QKR.
- g) Raportoi përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

Administratori është i detyruar të thërrasë në mbledhjen e Asamblesë në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratorët, së bashku edhe vecas njëri-tjetrit, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtzakonshëm. Administratorët e përfaqësojnë Shoqërinë përpara të gjithë personave fizik e juridik, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratorët angazhojnë shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nepërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretë e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose për të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbylljet në 31 dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) me vendim të ortakëve themelues

- c) me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtarë për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit"
- e) me vendim të Gjykatës

Në këtë rast Asamblea merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 13

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjiit "Për tregtarët dhe Shoqërit tregtarë", Kodit Civil dhe cfarë do ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky Akt Themelimi u redaktua në 4 kopje në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtarë Shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

ORTAKU I VETËM THEMELUES

Shtetasi Danez

Dann VINOTHER

Dann vinther

